

Data 09.03.2023

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Furnizim me Protoksid azoti në SUT”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

24111500-0__ Gazra mjekësore

VLERA E FONDIT LIMIT: 14,260,000 (katërbëdhjetë milionë e dyqind e gjashtëdhjetë mijë)
Lekë pa TVSH.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor **SUT** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës ...;
- b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Sipas shtojcës nr. 8 te formularit te vetëdeklarimit

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 40, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar,

.....

(Shënim: përcaktoni **nëse është rasti**, aktin konkret ligjor ose nënligjor që parashikon plotësimin e ndonjë kërkesë specifike për ushtrimin e veprimtarisë profesionale që lidhet me objektin e prokurimit).

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

Kopje të deklaratave të xhiros vjetore për tre vitet e fundit (2019-2020-2021). Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë duhet të jetë në masën 40% të fondit limit/vlerës së pritshme të kontratave. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Ky kriter i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës. Rëndësia e këtij gazi mjekësor justifikon vlerën 40% të kërkuar të xhiros, vlerë e ndodhur brenda marzhit të përcaktuar në aktet ligjore dhe nënligjore.

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohet, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në Ligjin nr. 9920 date 19.05.2008 ”Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, dhe aktet nënligjore ne zbatim te tij.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

a) Furnizime të mëparshme të ngjashme në një vlerë prej 20% të vlerës se fondit limit/vlerës së pritshme të kontratave, të realizuara gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës të kësaj procedure prokurimi.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

1. për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,

2. për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasisë e mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 55, pika 4/b të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Vlera e shërbimeve të ngjashme prej 20% të fondit të limit/ vlerës së pritshme të kontratave, të lotit apo shumës së loteve të parashikuar i jep siguri AK që operatorët kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën.

b. Auto-deklarate për origjinën e mallit, ku te përcaktohet vendi i prodhimit dhe kompania prodhuese.

c. Ofertuesi duhet të paraqesë autorizim nga prodhuesi i mallrave (ose distributori i autorizuar prej prodhuesit) për lejimin e tregtimit të mallrave të kërkuara në specifikimet teknike, të përkthyer dhe noterizuar. Në rast se OE është vet prodhues, duhet të paraqesë vetedeklarim me shkrim.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme janë përcaktuar për të njohur origjinën e mallrave dhe për të vërtetuar lidhjen e OE me prodhuesin ose distributorin e autorizuar, bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe neni 40, pika 8 të VKM 285 datë 19.05.2021.

d. Dokumente që vërteton se shoqëria ka në pronësi (ose kontrata qeraje), brenda territorit të Shqipërisë tankera për ruajtjen e gazrave mjekësore me një kapacitet 1/8 e sasisë së gazit që kërkohet të prokurohet, ose të ketë linjë prodhimi në vend. Këto të jënë gjendje në momentin e zhvillimit të tenderit.

e. Vërtetim për regjistrim dhe kontroll nga inspektorati i pajisjeve nën presion, për plotësimin e kushteve teknike dhe të sigurisë sipas legjislacionit në fuqi që vepron në RSH.

f. Kërkohen të paraqiten katalogë teknikë dhe/ose skedë teknike për mallrat e ofruara. Në katalogë/skedë teknike, specifikimet teknike të mallit duhet të markohen me ngjyrë të ndezur sipas specifikimeve teknike të kërkuara. (Katalogët duhet të ngarkohen në www.app.gov.al së bashku me dokumentacionin e kërkuar në këto DT (Dokumentet duhet të jënë të përkthyer dhe të motorizuara).

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme janë përcaktuar për të vërtetuar që operatori vepron sipas legjislacionit në fuqi bazuar në nenin 40, pika 8 të VKM 285 datë 19.05.2021 i ndryshuar si dhe plotëson kërkesat e AK dhe ka kapacitetet teknike për ruajtjen e mallit sipas standardit të kërkuar në specifikimet teknike.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Specifikimet sipas DST-se.

Argumentimi: Specifikimet teknike të mësipërme plotësojnë kushtin për materiale cilësore dhe janë përcaktuar në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, pika 3/b të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.